

SI TË DILET NGA

NGËRÇI NË KUVEND?

FAQE 4



Në rast se partitë politike nuk arrijnë një marrëveshje apo kompromis për votimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetarëve të tij, ato rrezikojnë ta bllokojnë

konstituimin e këtij institucioni ligjvënës dhe ta fusin vendin në ngërç institucional, thonë njohësit e çështjeve politike dhe kushtetuese. Seanca

konstituive e Kuvendit të Kosovës, e cila nisi më 15 prill, këtë të hënë u ndërpre për herë të katërt dhe për pasojë është shtyrë për sot (e mërkurë) në orën 10:00

KËRKOHET

PËRMBUSHJA

E OBLIGIMEVE

QË DALIN

NGA PROCESI

I BERLINIT

F. 3



BDI-ja SHPREH

SHQETËSIM PËR

MOSRESPEKTIMIN

SISTEMATIK TË GJUHËS

SHQIPE NË FAQET

ZYRTARE TË MINISTRIVE

F. 6



RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL

BUNJAKOL

CUROFASADË

AKTUALE



MARRËVESHJE PËR POZITËN

E KRYEPARLAMENTARIT

F. 5

SHALA KRITIKON QEVERINË PËR

SHPENZIMET PREJ MBI 29 MILIONË

EUROSH: SHËTITJE GLOBALE ME

REZULTAT ZERO, DO TË KËRKOJMË

SQARIME

F. 7

PROKURORIA KËRKON PARABURGIM

PËR TË DYSHUARIT PËR VRASJEN E

POLICIT LIKA

F. 7

EKONOMI



GËRXXHALIU: SIGURIA NË PUNË

DHE MBROJTJA NGA ZJARRI NË

KOSOVË DUHET TË NA

SHQETËSOJNË TË GJITHËVE

F. 8

ANKETUESIT E MICS 2025 DALIN

NË TERREN PËR LISTIMIN

E EKONOMIVE FAMILJARE

F. 8

SPORT



KOSOVA SHËNON FITOREN E DYTË

RADHAZI NË TURNEUN ZHVILLIMOR

TË UEFA-S

F. 10

Kolegji

BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

Papa Françesku do të varroset më 26 prill

VATIKAN, 22 PRILL - Varrimi i Papa Françeskut do të mbahet të shtunën, më 26 prill, në orën 10:00 në Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, njoftoi Vatikani të martën.

Françesku, i lindur si Jorge Mario Bergoglio në Buenos Aires të Argjentinës, vdiq më 21 prill në moshën 88-vjeçare. Ai vdiq nga sulmi në tru dhe si pasojë nga dështimi i pakthyeshëm i zemrës, tha Vatikani.

Papa Françesku konfirmoi në testamentin e tij të fundit se dëshironte të varroset në Bazilikën e Shën Marisë së Madhe në Romë dhe jo në Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, ndryshe nga shumë papë të mëparshëm.

Të martën Vatikani publikoi fotografitë e para të papës në arkivolin e tij të hapur, para se ai të transferohej në Bazilikën e Shën Pjetrit të mërkurën në orën 09:00, për t'u vendosur për homazhe publike.

Trupi i papës u fotografua gjatë

një shërbese të hënën në mbremje në kapelën e Casa Santa Marta, rezidenca në Vatikan ku ai jetoi gjatë 12 vjetëve të papatit të tij dhe ku ndërroi jetë.

Vendi i tij i origjinës, Argjentina, u përgatit për një javë të zisë kombëtare, ndërsa India filloi të martën tri ditë zie shtetërore - një nder i rrallë për një udhëheqës fetar të huaj në vendin më të populluar në botë. Liderë botërorë, nga presidenti i ShBA-së, Donald Trump, deri te Volodymyr Zelensky i Ukrainës, thanë se do të marrin pjesë për të nderuar udhëheqësin katolik. Në vitet e fundit, Papa Françesku ishte përballur me disa komplikime shëndetësore.

Më 2021, ai i ishte nënshtruar një operimi në zorrën e trashë, ndërsa më 2023 ka pasur një operim tjetër në abdomen për të trajtuar herninë.

Ai ishte përballur edhe me dhimbje kronike të gjurit dhe shpinës, dhe shpesh kishte



përdorur karrige lëvizëse.

Pavarësisht këtyre komplikimeve, ai pati agjendë të ngarkuar, dhe i kreu detyrat e një pape, si dhe udhëtoi nëpër botë. Në fillim të vitit 2025, ai u shtrua në spital për shkak të një infeksioni në traktin e

frymëmarrjes, çka më vonë i rezultoi me pneumoni të dyfishtë. Gjendja e tij ishte e rënduar, duke e detyruar të qëndronte ditë të tëra në spital. Si Papa i 266-të i Kishës Katolike Romane, ai ishte i pari prej kontinentit amerikan, dhe

i pari i lindur jashtë Evropës që u ngjit në krye të Selisë së Shenjtë, në më shumë se një mijëvjeçar.

Bergoglio, i biri i imigrantëve italianë, kishte punuar si teknik kimik para se t'iu bashkohej jezuitëve më 1958.

Ai ishte shuguruar si prift më 1969 dhe ishte bërë udhëheqës superior i jezuitëve të një province të Argjentinës në periudhën 1973-1979.

Më 1988, ai ishte emëruar peshkop i Buenos Airesit. Tre vjet më vonë, Papa Gjon Pali II e kishte ngritur atë në Kolegjin e Kardinalëve.

I zgjedhur Papë më 2013, pas dorëheqjes së Papa Benediktit XVI, ai e zgjodhi emrin Françesk, për të nderuar Shën Françeskun e Asizit, duke pasqyruar angazhimin e tij ndaj përlësisë dhe të varfërve.

Periudha e tij në krye të Selisë së Shenjtë kujtohet për fokusin në mëshirë, në drejtësinë sociale dhe kujdesin mjedisor.

Zelensky kërkon nga Rusia t'i kthejë fëmijët ukrainas

KIEV, 22 PRILL - Vladyslav Rudenko ishte 16-vjeçar kur u kap nga forcat ruse dhe u mbajt për nëntë muaj në kampet për fëmijë në Krimenë dhe Hersonin e pushtuar nga Rusia.

Për dallim nga 20 000 të rinj të tjerë ukrainas, Rudenko u shpëtua nga organizata joqeveritare "Save Ukraine" dhe u kthye në territorin e kontrolluar nga Ukraina pas nëntë muajsh në robëri.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, dhe zyrtarë të tjerë ukrainas, thonë në qendër të vëmendjes së tyre tani është fati i atyre mijëra fëmijëve, shumë prej të cilëve mbesin në zonat e pushtuara nga Rusia, në ato që Moskë i quan "qendra rehabilitimi". "Ky krim duhet të hetohet plotësisht dhe përgjegjësit duhet të japin llogari", tha ministri i Jashtëm i Ukrainës, Andriy Sybiha gjatë fundjavës, si pjesë e nisjes së fushatës #ChildrenAreNon-Negotiable. "Paqja e drejtë dhe e



qëndrueshme kërkon kthimin në shtëpi të të gjithë këtyre fëmijëve ukrainas", shtoi ai.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka bërë përfundimin e konfliktit më të gjatë në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore ndër synimet kryesore të politikës së tij të jashtme prej se e mori detyrën tre muaj më parë.

Derisa bisedimet zhvilluar në

lidhje me çështje të ndryshme dhe ndjeshme, çështja e riatdhesimit të të gjithë atyre që janë marrë nga Ukraina ka qenë ndër temat kryesore të negociimit nga zyrtarë ukrainas.

Zyrtarët ukrainas e kanë akuzuar Moskën për orkestrimin e atij që disa grupe e kanë quajtur "dëbim sistematik" të fëmijëve nga Ukraina drejt pjesëve të vendit të kontrolluara nga Rusia,

apo edhe përtej, në Rusi dhe aleaten e saj, Bjellorusi.

Prova të mbledhura vitin e kaluar nga Shërbimi bjellorus dhe ai ukrainas i Radios Evropa e Lirë sugjeruan se kampet po përdoren për t'i mësuar të rinjtë ukrainas ta identifikojnë veten me koncepte që promovohen nga Moskë dhe Minsku.

Kjo erdhi pas një studimi të nëntorit 2023 nga Laboratori i Kërkimeve Humanitare i Shkollës së Shëndetit Publik të Yale, i cili gjeti se udhëtimet e shoqëruara të nxënësve ukrainas në Bjellorusi po koordinoheshin nga Bjellorusia dhe Rusia si pjesë e të ashtuquajturit Shtet i Bashkuar mes dy vendeve.

Studimi gjeti se ky proces përfshin "riarsimim", apo "promovim i mesazheve ose ideve kulturore, historike, shoqërore dhe patriotike që i shërbejnë interesave politike" të dyja regjimeve. Sipas raportit, stërvitje ushtarake, përfshirë nga trupa të Ministrisë së

Brendshme, janë zhvilluar me "të paktën gjashtë grupe fëmijësh". Rudenko i tha Shërbimit ukrainas të REL-it në fillim të këtij muaji se gjatë kohës sa ishte mbajtur nga autoritetet ruse, rutina e tij e përditshme kishte orientim të qartë. "Zgjoreshim me himnin rus, ngrinim flamurin, dhe bënim ushtrime. Pas mëngjesit, na tregonin çfarë kishte ndodhur gjatë natës në Rusi. Fjalë për fjalë. Pastaj shikonim filma rusë", tha ai, duke përshkruar regjimin gjatë qëndrimit në kampe.

Sipas Laboratorit Humanitar të Yale, më shumë se 8.400 fëmijë nga Ukraina janë zhvendosur sistematikisht në të paktën 57 qendra: 13 qendra në Bjellorusi dhe 43 qendra në Rusi apo në territore të pushtuara nga Rusia. Sipas portalit zyrtar të Qeverisë ukrainase childrenofear.gov.ua, numri është shumë më i madh - rreth 20.000 - ndërsa vetëm 1.300 fëmijë janë kthyer me sukses.

Kina paralajmëron vendet e tjera të mos bëjnë marrëveshje tregtare me ShBA-në në dëm të saj

PEKIN, 22 PRILL - Kina i ka paralajmëruar vendet e tjera që të mos bëjnë marrëveshje tregtare me Shtetet e Bashkuara në dëm të Kinës.

Qeveritë, përfshirë ato të Tajvanit, Japonisë dhe Koresë së Jugut, i kanë filluar bisedimet me Uashingtonin pasi presidenti amerikan, Donald

Trump, vendosi tarifa të larta kundër pothuajse të gjithë partnerëve tregtarë të Amerikës më 2 prill.

Taksat mbi importet u pezulluan shpejt për shumicën e vendeve pas një paniku në tregje, por Trump i rriti edhe më shumë larta kundër Kinës.

"Kina kundërshton fuqishëm

çdo marrëveshje që bëhet në kurriz të interesave kineze", tha Ministria e Tregtisë e Kinës në një komunikatë. "Nëse kjo ndodh, Kina nuk do ta pranojë kurrë dhe do të marrë kundërmasa në mënyrë të vendosur dhe të barabartë. Kina është e vendosur dhe e aftë t'i mbrojë të drejtat dhe

interesat e saj", tha ajo.

Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, tha më herët këtë muaj se vendet që janë duke negociuar marrëveshje tregtare me ShBA-në duhet t'i "qasen Kinës si një grup" së bashku me Uashingtonin.

Tarifat amerikane ndaj vendeve të tjera përbëjnë një formë të



ngacmimit ekonomik, tha Ministria kineze.

KËRKOHET PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE QË DALIN NGA PROCESI I BERLINIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 PRILL - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, ka mbajtur të martën një tryezë diskutimi në të cilën ka publikuar Raportin e tretë të monitorimit me titull “Procesi i Berlinit në Agjendën e Reformave Evropiane të Kosovës: Angazhimet për tregun e përbashkët rajonal dhe agjendën e gjelbër”.

Gjatë shpalosjes së raportit Violeta Haxholli nga KDI-ja tha se është analizuar progresi i Kosovës në këtë proces, ku janë identifikuar sfidat në zbatimin e zotimeve nga ana e Kosovës në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal/Digjitalizimit dhe Agjendës së Gjelbër/Dekarbonizimit, ku janë sugjeruar hapa konkret për zbatim efektiv.

Po ashtu, u përmend që këta komponentë janë pjesë integrale e Agjendës për Reforma Evropiane për Kosovën dhe Planin e Rritjes.

Ndërsa u theksua nevoja për konstituim të shpejtë të Kuvendit të Kosovës për ta miratuar legjislacionin e nevojshëm që ndërlihet me zbatimin e zotimeve të procesit të Berlinit.

Ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka theksuar se Republika e Kosovës ka dëshmuar përkushtim të lartë politik dhe institucional ndaj Procesit të Berlinit, duke qenë një nga vendet më proaktive në rajon duke ratifikuar me efikasitet marrëveshjet përkatëse. Megjithatë, ajo theksoi sfidat politike që pengojnë zbatimin,

si bllokimi nga Serbia në transmisionin e energjisë, që ka sjellë humbje ekonomike për Kosovën por edhe gjithë rajonin.

Në fushën e digjitalizimit, ajo tha se vendi ka shënuar përparim - me mbulim të plotë të territorit me internet, kalimin në teknologjitë 4G, 4G+ dhe 5G, dhe rritjen e numrit të shërbimeve publike online nga 21 në 170 në katër vitet e fundit. Sipas saj, edhe në energji, Kosova ka shtuar 500 megavat kapacitete të reja pas 40 vitesh dhe ka miratuar Ligjin për Energji të Ripërtërishme.

Rizvanolli tha se janë zhvilluar shtatë skema për efikasitet energjetik, si dhe është përmbyllur ankandi i parë solar dhe është në zhvillim i dyti me kapacitet prej 200 megavat. Në këtë kontekst ajo tha se, prioritetet e Qeverisë mbeten përmirësimi i infrastrukturës kritike dhe rritja e qëndrueshmërisë ndaj sfidave klimatike, veçanërisht në sektorin e ujit dhe energjisë - fusha që kërkojnë bashkëpunim më të thelluar rajonal në të ardhmen.

Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP), Burim Ejupi, theksoi rolin aktiv të shoqërisë civile në Procesin e Berlinit që nga Samiti i Triestes, duke shtyrë agjendën e energjisë së gjelbër dhe transportit të qëndrueshëm.

Ai kritikoi mungesën e progresit të Kosovës në infrastrukturën hekurudhore dhe pengesat politike që vonojnë projektet. Në sektorin e digjitalizimit, e vlerësoi Kosovën si pionere, sidomos me platformën e-Kosova dhe suksesin e



marrëveshjes së Roaming-ut, por tha se duhet të përshtet ritmi për të arritur marrëveshjen e Roaming me BE-në.

Sa i përket energjisë, ngriti shqetësime për mosmiratimin e Planit të ri për Energji dhe Klimë dhe mungesën e transparencës nga qeveria, ndonëse shoqëria civile ka kontribuar me komente e rekomandime. Ai theksoi nevojën për më shumë përfshirje të OSHC-ve, transparencë dhe llogaridhënie në projektet që lidhen me fondet dhe zotimet e Procesit të Berlinit, duke rikujtuar se shoqëria civile avokon për interesin publik.

Fjalën në këtë tryezë e mori edhe zëvendësambasadori

Gjerman në Kosovë, Matthias Conrad, i cili shtoi se Procesi i Berlinit është një kornizë e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që ka mbështetjen e vazhdueshme të qeverive gjermane nga kancelarët Angela Merkel tek Olaf Scholz si dhe koalicioni i ri që pritët të formohet. Ai nënvizoi rëndësinë e këtij procesi për Kosovën, duke e cilësuar si një platformë ku Kosova trajtohet në mënyrë të barabartë me vendet tjera.

Duke përmendur njohjen e dokumenteve me Bosnjën si një hap të guximshëm nga ana e Kosovës, ai vlerësoi progresin në CEFTA dhe theksoi domosdoshmërinë që qeveritë të marrin vendime të

guximshme për zbatimin e zotimeve, ndërsa tha se roli i shoqërisë civile është të kërkojë llogaridhënie dhe të sigurojë që këto angazhime të zbatohen. Në fund u theksua nevoja për angazhim më të madh në përmbylljen e detyrave që dalin nga procesi i Berlinit dhe koordinim më i madh ndërinstytucional dhe me komunitetin.

Ky diskutim dhe raport analitik u realizua në kuadër të projektit: “Diplomacia parlamentare: Bashkëpunimi rajonal përmes dialogut të zgjeruar parlamentar”, i zbatuar me organizatat partnere nga rajoni, me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme.

BDI-ja SHPREH SHQETËSIM PËR MOSRESPEKTIMIN SISTEMATIK TË GJUHËS SHQIPE NË FAQET ZYRTARE TË MINISTRIVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

SHKUP, 22 PRILL - Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) ka shprehur shqetësim për mosrespektimin sistematik të gjuhës shqipe në faqet zyrtare të ministrive të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. “Mungesa e përmbytjes në gjuhën shqipe në Ministrinë e Energjetikës, të Transportit, të Punëve të Brendshme dhe në institucione të tjera përbën jo vetëm shkelje të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, por edhe përjashtim të qëllimshëm të qytetarëve shqiptarë nga qasja në informatat publike. Në disa raste, janë ruajtur vetëm formatet e vjetra në gjuhën



shqipe, të mbetura nga qeveria paraprake, por përmbytjet konkrete, dokumentet dhe informacionet kryesore figurojnë ekskluzivisht në maqedonisht”,

është thënë në reagimin e BDI-së, duke theksuar tutje se ky është një trend i rrezikshëm që shkon përtej neglizhencës teknike. “Është politikë

institucionale që kufizon përdorimin praktik të gjuhës shqipe dhe rrënon bazat e barazisë ndëretnike në shtet. Për më tepër, këto zhvillime vijnë në një moment kur bëhen përpjekje për të vënë në pikëpyetje vetë dispozitat kryesore të Ligjit për Gjuhët në Gjykatën Kushtetuese. Kur institucionet shtetërore fillojnë të injorojnë ose të relativizojnë një nga arritjet më të rëndësishme të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit - përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe - dërgohet një mesazh i rrezikshëm për të ardhmen e kohezionit shtetëror dhe bashkëjetesës ndëretnike”, theksohet në reagim.

Sipas BDI-së, derisa ndodhin këto procese të rënda, partnerët

shqiptarë në qeveri janë zhytur në grindje të brendshme për kryetar të LEN-it edhe pse secili me nga më pak se 1 % mbështetje të qytetarët, dhe heshtin përballë kësaj goditjeje ndaj të drejtave të qytetarëve shqiptarë. “Me këtë heshtje, ata jo vetëm që e legjitimojnë këtë qasje, por janë bërë pjesë e problemit. BDI i bën thirrje institucioneve të respektojnë ligjin dhe Kushtetutën, të ndalojnë diskriminimin gjuhësor dhe të reflektojnë për pasojat e këtij kursi. Shqiptarët nuk do të pranojnë të trajtohen si qytetarë të rendit të dytë. Barazia gjuhësore nuk është privilegj - është e drejtë”, është thënë në reagimin e partisë së Ali Ahmetit.



SI TË DILET NGA NGËRÇI NË KUVEND?

PRISHTINË, 22 PRILL - Në rast se partitë politike nuk arrijnë një marrëveshje apo kompromis për votimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetarëve të tij, ato rrezikojnë ta bllokojnë konstituimin e këtij institucionit ligjvënës dhe ta fusin vendin në ngërç institucional, thonë njohësit e çështjeve politike dhe kushtetuese.

Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, e cila nisi më 15 prill, këtë të hënë u ndërpre për herë të katërt dhe për pasojë është shtyrë për të mërkurën në orën 10:00.

Lëvizja Vetëvendosje (LV), partia fituese e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, si dhe tri partitë tjera, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë fajësuar njëra-tjetrën për bllokim të konstituimit të Kuvendit.

Lëvizja Vetëvendosje, e cila këmbëngul në propozimin që deputetja e saj, Albulena Haxhiu, të jetë kryetare e Kuvendit, ka kërkuar marrëveshje me partitë e tjera politike për këtë çështje, si dhe për zgjedhjen e nënkryetarëve

të legjislativit.

Propozimi i LV-së është kundërshtuar në vazhdimësi nga PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja.

Kompromisi i mundshëm

Albert Krasniqi nga Demokraci Plus (D+) në Prishtinë, thotë për Radion Evropa e Lirë se në aspektin politik, konstituimi i Kuvendit gjendet në një bllokadë, për shkak të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila nuk ka rritur t'i sigurojë 61 votat e domosdoshme nga deputetët, për ta miratuar propozimin e saj.

“Kur nuk i ke numrat, duket kompromis dhe nuk mund të imponosh kandidatë [për kryetar të Kuvendit]”, thekson Krasniqi.

Ai shton se, marrë parasysh refuzimin kategorik të propozimit të LV-së nga tri partitë tjera, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, partia fituese do të duhej të lëshonte pe. “Do të duhej që Lëvizja Vetëvendosje të bënte përpjekje për të dialoguar me partitë politike, në mënyrë që të ketë një kandidat të përshtatshëm - së paku për shumicën e deputetëve - në mënyrë që ta zhblllokojë situatën”, thotë

Krasniqi.

Mendim të ngjashëm ka edhe profesori i të Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu. Ai thekson se deri të mërkurën, kur pritet vazhdimi i seancës, partitë politike duhet ta gjejnë një kompromis, i cili do ta zhblllokonte ngërçin, në të cilin ka ngecur konstituimi i Kuvendit.

Kompromisi, sipas tij, nënkupton një marrëveshje që përfshin propozimet në pako, për kryetarin e Kuvendit dhe për pesë nënkryetarët, nga partitë shqiptare dhe të komuniteteve pakicë joserbe dhe serbe. “Gjatë këtyre 48 orëve, të merren vesh [partitë politike] që në pako të gjejnë kompromis. Pra, nëse jo me këtë kandidat - që tri here i ka dështuar partisë apo koalicionit fitues - atëherë me ndonjë kandidat tjetër, i cili mund të jetë më i pranueshëm për partitë e tjera, si kryetar Kuvendi, si dhe për kandidatët për nënkryetarë”, thekson Baraliu.

Sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, çdo ndërprerje e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, nuk mund të zgjasë më shumë se 48 ore.

Përderisa PDK-ja dhe AAK-ja

kanë sugjeruar se Lëvizja Vetëvendosje duhet ta propozojë një kandidat tjetër të pranueshëm për partitë politike, LDK-ka ka theksuar se nuk do ta votojë asnjë kandidat të LVV-së për kryeparlamentar.

Çfarë në rast se nuk ka kompromis ndërmjet partive politike?

Mungesa e marrëveshjeje eventuale ndërmjet partive politike që do ta zgjidhte situatën për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, do ta thellonte edhe më tej ngërçin institucional. Të këtij mendimi janë Krasniqi dhe Baraliu.

Siç thonë ata, në rast se nuk ka pajtim ndërmjet partive politike për zgjedhjen e kryetarit i Kuvendit edhe të mërkurën, nuk ka ndonjë kufizim ligjor që seanca konstituive të vazhdojë çdo 48 orë pas secilës ndërprerje, “deri në pafundësi”.

Krasniqi shpreh mendimin se Lëvizja Vetëvendosje mund të vazhdojë të mos propozojë një emër tjetër për kryetar Kuvendi. “Nëse LV-ja nuk propozon emër, atëherë kjo

mund të kontestohet në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se e drejta për të propozuar nuk nënkupton edhe të drejtën për të imponuar kandidat dhe, aq më pak, për të bllokuar konstituimin e Kuvendit”, thotë Krasniqi.

Por, të drejtën për t'iu drejtuar për çështje të caktuara Gjykatës Kushtetuese e kanë vetëm presidentja e Kosovës, avokati i popullit dhe Kuvendi i Kosovës.

Profesor Baraliu shpreh mendimin se para se ndonjëri nga institucionet eventualisht t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për çështjen e zhbllokimit të procesit të konstituimit të Kuvendit, mund të ndërhyjë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Ai thekson se presidentja Osmani ka kompetencë kushtetuese që të garantojë mbarrëvajtjen dhe “funksionimin kushtetues të institucioneve”. “Në këtë rast mbarrëvajtja nënkupton - edhe proceduralisht - fillimi dhe vazhdimi i konstituimit të Kuvendit. Mbi këtë bazë, ajo mund të intervenojë në çdo kohë”, theksoi Baraliu. Megjithatë, ndërhyrja e presidentes në këtë rast është

MARRËVESHJE PËR POZITËN E KRYEPARLAMENTARIT

PRISHTINË, 22 PRILL - Sot (e mërkurë) do të vazhdojë seanca konstitutive e Kuvendit të Kosovës. Në rend ditë do të jetë zgjedhja e kryetarit të këtij institucioni.

Lëvizja Vetëvendosje, partia fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, ka propozuar deputeten Albulena Haxhiun për postin e kryeparlamentares, por dy herë kandidatura e saj nuk ka marrë shumicën e deputetëve.

Analisti politik Shkelzen Maliqi ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje e ka të drejtën e propozimit të kandidatit për kryetar të Kuvendit, kurse të gjithë deputetët e kanë të drejtën për ta pranuar dhe refuzuar propozimin. “Me arsye ose pa

arsye është refuzimi, nuk e pranon shumica. Në demokracitë e avancuara ky refuzim nuk konsiderohet diçka tragjike, mbahen konsulta për të gjetur zgjidhje, ndonjë kandidat tjetër që është i pranueshëm për shumicën. Kjo nuk do të thotë mohim i së drejtës që fituesi ta propozojë kandidatin, sërish propozimi vjen nga fituesi, por tani me pajtimin e një pjese të palës tjetër që siguron shumicën”, ka thënë Maliqi.

Edhe profesori universitar Milazim Krasniqi ka folur për situatën e fundit politike në vend. Ai ka thënë se LV-ja i ka bllokuar Kuvendin e qeverinë. “Faktikisht e ka paralizuar Kosovën. Nuk do kompromis

me partitë shqiptare parlamentare, thjesht nuk do zgjidhje të problemit. I bie se po e dëmton shtetin. Pyetja që ngrihet: kush përfiton nga një Kosovë e paralizuar? Kosova, apo armiqtë e saj?”, ka theksuar Krasniqi.

Politikania Edita Tahiri ka thënë se dështimi i katërt i konstituimit të Kuvendit kërkon marrëveshje politike për organet e Kuvendit dhe për qeverinë e koalicionit në një pako. “PDK-së i takon kryeministri, Kurtit për t'i premtuar se bahet president pas kalimit të mandatit të Vjosës. Kësaj të fundit i vjen keq, por mjaft e ka pasur një mandat si presidente gojëmbyllur që ishte”, është shprehur Tahiri.



RAMADANI: KOSOVA, SHQIPËRIA E KROACIA TA FILLOJNË BASHKËPUNIMIN NË MBROJTJE



PRISHTINË, 22 PRILL - Pas marrëveshjes së nënshkruar për mbrojtje në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë, ish-inspektori i përgjithshëm i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI), Burim Ramadani, ka kërkuar të konkretizohen bashkëpunimet mes tyre. Ramadani përmes një postimi në rrjetin social “Facebook” ka shkruar se tre vendet duhet ta formalizojnë organizimin e ushtrimeve të përbashkëta ushtarake dhe të krijojnë qendra trajnimi rajonal. “Për të

filluar zbatimin konkret të iniciativës së marsit 2025 në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, Kosova, Kroacia dhe Shqipëria duhet të ndërtojnë saktësisht mënyrat e veprimit. Duhet të formalizojnë bashkëpunimin përmes krijimit të një strukture koordinuese të përhershme, që do të vendosej në Prishtinë”, ka shkruar ai.

Më tutje Ramadani ka thënë se duhet ta planifikojnë organizimin e ushtrimeve të përbashkëta ushtarake dhe krijojnë qendra trajnimi

rajonal. “Duhet të forcojnë bashkëpunimin në fushën e inteligjencës dhe sigurisë kibernetike. Duhet të zgjerojnë planet në sigurinë civile, përfshirë reagimin ndaj emergjencave. Duhet të veprojnë të bashkërenduara në diplomacinë e sigurisë në forumet ndërkombëtare, përfshirë promovimin e Kosovës për anëtarësim në NATO”, ka shkruar Ramadani. Shqipëria, Kosova dhe Kroacia kanë nënshkruar marrëveshje trilaterale në fushën e mbrojtjes.

Kurti vizitoi për ngushëllime familjen Shaqiri

Ferizaj, 22 prill- Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me deputetë të zgjedhur, anëtarë të kabinetit qeveritar dhe aktivistë të Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Ferizaj, vizitoi

për ngushëllime familjen e të ndjerit Sylejman Shaqiri, ish-drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës dhe gazetar i mirënjohur. Kryeministri Kurti i shprehu ngushëllimet më të përzemërta

familjes Shaqiri dhe të gjithë miqve të të ndjerit për këtë humbje të madhe. “Profesionist me kompetencë dhe integritet, qytetar me bujari e patriotizëm, ferizajas me dije e shije, Sylejman Shaqiri ka lënë

gjurmë të pashlyeshme, kontribut të paçmueshëm dhe kujtime të paharrueshme te të gjithë ne që e njohëm dhe te shoqëria mbarë”, ka shkruar kryeministri në librin e ngushëllimeve.



vetëm një lloj ndërmjetësimi ose ftese për partitë politike që të merren vesh për ta çuar në fund procesin e konstituimit të Kuvendit.

Në të kundërtën, sipas Baraliut, presidentja Osmani, Avokati i Popullit ose një grup deputetësh të Kuvendit, mund ta dërgojnë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, “për vlerësim lidhur me kufizimin e afateve për konstituimin e Kuvendit, e sidomos për atë se a ka kufizime lidhur me përsëritjen e vazhdimit të seancës për çdo 48 orë”. “Çfarë duhet bërë në këtë situatë? Gjykata [Kushtetuese] e ka pasur edhe një deklaram me herët që të mos bëhen pyetje të tilla ‘çka dhe si’. Por, duhet gjetur një formulim i duhur, në mënyrë që ta detyrojë Gjykatën që të japë një

mendim adekuat dhe kompetent”, u shpreh Baraliu. “Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar Presidencës së Kosovës lidhur me këtë çështje, por deri në publikimin e këtij artikulli, nuk ka marrë përgjigje.

Javën e kaluar, Osmani kishte shprehur gatishmërinë e saj për të biseduar me partitë politike për rrugën përpara, nëse ato e shohin këtë të nevojshme. Duke marrë për bazë mospajtimet ndërmjet partive politike lidhur me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, nga Lëvizja Vetëvendosje, të hënën është thënë se duhet të thirren grupet politike, të konstituohet Kuvendi dhe më pas, të arrihet pajtimi që ai të shpërndalet dhe vendi të shkojë në zgjedhje.

Pse po kundërshtohet Haxhiu?

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se Lëvizja Vetëvendosje duhet ta propozojë një kandidat tjetër të pranueshëm për partitë politike. “Kandidatja Haxhiu nuk do ta ketë mbështetjen tonë, në asnjë rrethanë, në asnjë moment. Ajo është simbol i dështimit të kësaj qeverie në katërvjeçarin e kaluar. Krejt mandatit e ka pasur të përcjellë me skandale të ndryshme, prej zhdukjes së

mostrave të Astrit Deharit e deri te ulja e buxhetit për mbrojtjen e çlirimtarëve në Hagë. Ka shumë, shumë, shumë dështime - në mesin e të cilave edhe ky ligji banal për qeverinë, i cili e ka lidhur nyje pikërisht Vetëvendosjen. Rruga është e qartë: duhet të ndryshohet kandidati, pastaj ndoshta mund të bëhet shumica”, tha Krasniqi më 21 prill. AAK-ja ka thënë se nuk do ta votojë Albulena Haxhiun për kryetare të Kuvendit, por do

ta mbështeste Saranda Bogujevcin apo Shqipe Selimin, bashkëshortja e Rexhep Selimit. Vetë Bogujevci ka thënë se Vetëvendosje e ka propozimin e vet, të cilin e mbështet. “Nuk jeni ju ata që na tregoni se kush duhet me qenë zot i shtëpie më të rëndësishme të Republikës së Kosovës kur me votë e ka vendosur populli”, ka shkruar Bogujevci në “Facebook”.

DhTIK: Shkaku i Ligjit të Pronës Publike shumë biznese janë buzë falimentimit

PRISHTINË, 22 PRILL - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka ngritur alarmin se bizneset e sektorit minerar janë afër falimentimit shkaku i bllokadave të krijuara me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pronën Publike. Në një konferencë për medie, DhTIK bëri thirrje për zhblokim të situatës politike dhe hapat konkretë në drejtim të përmirësimit të gjendjes. Drejtori i Dhomës së Tregtisë

dhe Industrisë Kosovë, Kushtrim Ahmeti, ka thënë se Ligji për Pronën Publike ka shkaktuar telashe jashtëzakonisht të mëdha duke bllokuar funksionimin edhe të shumë institucioneve. “Ligji për Pronën Publike, i cili ka shkaktuar telashe jashtëzakonisht të mëdha, sepse ka bllokuar shumë institucione në funksionimin e tyre, për shkak se ky ligj ka shkelur ligjet e tjera, ka

bllokuar ligje të tjera për të funksionuar dhe ka shkaktuar një bllokadë totale të një numër i madh i institucioneve në vendin tonë. Janë një numër i madh i kompanive në sektorin minerar dhe jo vetëm të cilat janë bllokuar në pamundësi për ta kryer aktivitetin e tyre punues shkaku i mosfunksionimit në këtë rast të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Agjencisë së

Pyjeve të Kosovës, të cilat janë bllokuar shkaku i futjes së Ligjit të Pronës Publike rreth fundit të vitit 2023 dhe që nga ajo kohë e deri më sot numri i këtyre bizneseve po vazhdon të rritet, sepse koha po vazhdon dhe nuk ka ndonjë lëvizje të zhblokohet kjo situatë deri më tani”, ka theksuar ai. Ahmeti ka pohuar se përkundër përpjekjeve të Dhomës, nuk ka pas ndonjë



lëvizje adekuate në drejtim të përmirësimit të kësaj situatë, prandaj përsëri kërkoi që sa më shpejt të ketë formim të institucioneve shtetërore.

ZYRA E KE-së NË PRISHTINË ORGANIZON TRYEZË PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE DHE TË DREJTËN PËR NJË GJYKIM TË DREJTË

PRISHTINË, 22 PRILL - Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës (KE) për mbështetjen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut, Zyra e KE-së në Prishtinë ka organizuar një tryezë për ekzekutimin e aktgjykimeve dhe të drejtën për gjykim të drejtë, në të cilën mori pjesë anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku. Pjesëmarrës të kësaj tryeze ishin përfaqësuesit e Zyrës së KE-së në Prishtinë, të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Supreme,

Gjykatës së Apelit, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Qëllimi i tryezës ishte të ofrojë një platformë për dialog dhe për shkëmbimin e përvojave mes përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, prokurorial dhe shoqërisë civile për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të juridiksioneve të ndryshme dhe të adresojë çështjet dhe sfidat kryesore në të ardhmen. Gjatë prezantimit të tij, në cilësinë e njërit prej folësve kryesorë, Jetish Maloku, ka theksuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës, si një ndër shtyllat kryesore të sistemit të drejtësisë,



është i përkushtuar të mbështesë çdo përpjekje që çon drejt përmirësimit të mekanizmave të zbatimit të

aktgjykimeve. “Një gjykim i drejtë nuk përfundon me shpalljen e një vendimi, por përbushet vetëm kur vendimi

respektohet dhe zbatohet në praktikë dhe kjo na vendos përballë një reflektimi të thellë që do të duhej të ishte elementi përmbyllës i çdo procesi gjyqësor, pra zbatimi i drejtë, i plotë dhe me kohë i aktgjykimeve”, ka thënë Maloku para pjesëmarrësve të kësaj tryeze. Në vazhdim të tryezës diskutimet vazhduan me kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, me fokus kryesisht në ekzekutimin e vendimeve nga këndvështrimet krahasuese dhe ekzekutimin e aktgjykimeve të gjykatave të gjitha juridiksioneve.

AKB-ja KUNDËR THIRRJEVE PËR BOJKOT: PATRIOTIZMI MATET ME MBËSHTETJE PËR EKONOMINË VENDORE



PRISHTINË, 22 PRILL - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka reaguar pas thirrjes së sekretarit organizativ të Vetëvendosjes, Alim Rama, për bojkotimin e produkteve vendore të kompanive të Devollëve. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, në një prononcim për “Kosova.info”, e ka quajtur këtë qasje të papranueshme dhe të dëmshme për ekonominë e vendit. “Thirrjet për bojkotimin e produkteve vendore janë të papranueshme dhe dëmtojnë drejtpërdrejt ekonominë tonë, punëtorët tanë dhe të ardhmen

e vendit. Askush, e aq më pak një përfaqësues politik, nuk guxon ta godasë sektorin privat - motorin e vetëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës”, u shpreh Shahini. Ai theksoi se kompanitë vendore, si ato të Devollëve, janë ndër kontribuuesit më të mëdhenj në ekonominë e Kosovës duke krijuar mijëra vende pune dhe duke mbushur arkën e shtetit me qindra miliona euro. “Slogani ynë është i qartë dhe i fuqishëm: ‘Unë konsumoj produkte vendore, po ju?’. Prandaj ftoj qytetarët e Kosovës ta rritin

konsumimin e produkteve tona e jo t'i bojkotojnë ato”, shtoi ai. Shahini përmbylli reagimin e tij duke theksuar se patriotizmi sot nuk matet me fjalë, por me veprime konkrete që forcojnë ekonominë dhe shtetin. “Patriotizmi sot matet me mbështetje për ekonominë tonë vendore”, theksoi ai. AKB-ja ka bërë thirrje për ndaljen e sulmeve ndaj bizneseve dhe për bashkëpunim të të gjitha institucioneve me sektorin privat, si shtyllë kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit.

Smajl Latifi: Sot për tokën, çdo ditë për të ardhmen!

RAHOVEC, 22 PRILL - “E nisa ditën me energji pozitive, me fëmijët e çerdhës ‘Tulipanët’ në Rahovec, ku së bashku mbollëm lule dhe pemë në oborrin e çerdhës. Fëmijët, përmes këtij aktiviteti, mësojnë rëndësinë e kujdesit për natyrën dhe të mbrojtjes së mjedisit”, ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl

Latifi. Ai ka treguar se më pas mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga SHL Kosova, ku bashkë me të rinjtë diskutuam për sfidat mjedisore, angazhimin e tyre dhe përkushtimin tonë institucional për të çuar përpara projektet e gjelbra. “Pas kësaj, me bashkëpunëtorë, vizituam

edhe punëtorët e Kompanisë Rajonale të Pastrimit ‘Ekoregjioni’, të cilët po bëjnë pastrimin e hapësirave përgjatë rrugës rajonale në drejtim të Malishevës. Më vonë do të publikojmë edhe pamje nga aktivitetet që po zhvillohen në shkollat tona, ku nxënësit, në bashkëpunim me

mësimdhënësit, po kujdesen për pastrimin e hapësirave brenda dhe jashtë shkollës. Çdo hap i vogël që bëjmë sot ka ndikim të madh nesër. Le të angazhohemi çdo ditë për mbrojtjen e mjedisit dhe të krijojmë një botë më të pastër e më të shëndetshme për të gjithë ne!”, ka thënë Latifi.



Gatishmëria për emergjencë, AME hap javën e aktiviteteve

PRISHTINË, 22 PRILL - Agjencia e Menaxhimit Emergjent në hapje të Javës së Aktiviteteve ka ekspozuar pajisjet e zjarrfikësve, ekipit të barrierave dhe ekipit për shuarjen e zjarreve malore nga toka. Drejtori i AME-së, Genc Metaj,

ka thënë se qëllimi i tyre është të ndikojnë në vetëdijesim dhe të jenë afër qytetarëve. “Qëllimi ynë është edhe ta promovojmë rolin dhe rëndësinë e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit,

strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe masat që duhet të ndërmerren në rast të fatkeqësive, veçanërisht të fokusohemi në parandalimin e tyre”, është shprehur Metaj. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe ministri në

detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Agjencia e Menaxhimit Emergjent udhëheq dhe koordinon përpjekjet shtetërore në parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje në rastet e emergjencave.



PROKURORIA KËRKON PARABURGIM PËR TË DYSHUARIT PËR VRASJEN E POLICIT LIKA

PRISHTINË, 22 PRILL - Prokuroria e Ferizajt i ka kërkuar të martën gjykatës të urdhërojë një muaj paraburgim për gjashtë të dyshuarit e arrestuar një ditë më parë në lidhje me vrasjen e rreshterit të Policisë së Kosovës, Muhamed Lika.

Të dyshuarit, të cilët u identifikuan nga prokuroria vetëm me inicialet H. B., R. M., V. Ç., E. L., Sh. K. dhe D. G., vijnë nga Kaçaniku në jug të Kosovës. Ata akuzohen për vrasje të rëndë.

Muhamed Lika u vra natën e 1 prillit në shkallët e ndërtesës ku jeton në Kaçanik, derisa po kthehej në banesën e tij nga puna. Ai u vra pasi u qëllua



mbrapa shpinës nga një i mitur, i cili veproi në bashkëkryerje me pesë të dyshuarit e tjerë, rreth mesnatës së 1 prillit pak pasi

kishte hyrë në ndërtesën ku jeton, tha prokuroria. Që të gjashtë të dyshuarit u arrestuan të hënën gjatë një

operacioni të gjerë policor në Kaçanik dhe u dërguan në mbajtje për 48 orë. Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, thanë në një konferencë për medie në Ferizaj se dyshimet e para janë se motivet e vrasjes kanë të bëjnë me punën e rreshterit si zyrtar policor. “Dyshimet e tona të deritanishme janë se vrasja e rreshterit tonë ka ndodhur për shkak të detyrës së tij zyrtare. Megjithatë, motivet do të qartësohen edhe pas intervistimit të personave të dyshimtë dhe pas ekzaminimit të

dëshmime të gjetura. Kjo mbetet të vërtetohet”, tha Hoxha. Hoxha dhe Çerkini thanë se disa prej tyre kanë të kaluar kriminale dhe se Lika kishte punuar në zgjidhjen e disa rasteve ku ata dyshoheshin për vepra penale. “Disa nga të arrestuarit kanë pasur të kaluar kriminale dhe kanë qenë të arrestuar në të kaluarën për raste në lidhje me prirje ekstremiste”, tha Hoxha. Policia kreu bastisje në nëntë lokacione në Kaçanik dhe në një fshat të Klinës të hënën, duke sekuestruar dy vetura, telefona mobilë, disa laptopë, një armë zyrtare, maska, tyta armësh dhe fishekë.

SHALA KRITIKON QEVERINË PËR SHPENZIMET PREJ MBI 29 MILIONË EUROSH: SHËTITJE GLOBALE ME REZULTAT ZERO, DO TË KËRKOJMË SQARIME

PRISHTINË, 22 PRILL - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, për “FrontOnline” ka folur për shpenzimet e institucioneve gjatë tri viteve të fundit, të cilat kanë arritur në mbi 29 milionë euro për udhëtime zyrtare jashtë vendit, mëditje dhe akomodim.

Shala ka theksuar se rritja enorme e këtyre shpenzimeve nuk ka sjellë asnjë kthim real për vendin, duke vënë në pah mungesën e rezultateve konkrete dhe dëmet që, sipas

tij, po u shkaktohen qytetarëve. “Është e vërtetë se ka një rritje enorme të shpenzimeve të qeverisë por, fatkeqësisht, nuk kemi një rezultat kthyes dhe sikur të arsyetoheshin shpenzimet e qeverisë me të hyrat politike të vendit”, ka deklaruar Shala. Ai ka theksuar se këto shpenzime jo vetëm që nuk kanë përmirësuar pozitën ndërkombëtare të vendit, por kanë ndikuar negativisht në raportet me partnerët strategjikë dhe në klimën investuese. “Të gjitha këto

shpenzime të mëdha kanë rezultuar që sot ne nuk kemi raporte bashkëpunimi me shumë institucione ndërkombëtare dhe vendore. Sot ne nuk kemi investitorë të ardhshëm. Të gjitha këto shëtitje nëpër glob kanë rezultuar me rezultat zero”, ka thënë ai. Deputeti i PDK-së e ka quajtur qeverinë joefikase, duke e lidhur rritjen e shpenzimeve me përkeqësimin e gjendjes ekonomike të qytetarëve. “Qeveria ka rritur shpenzimet,



por efikasiteti i saj ka qenë minimal. Këto shpenzime kanë reflektuar në gjithë parametrat zinxhior dhe këto i atakojnë edhe qytetarët – në vazhdimësi do të kemi inflacion të rritjes”, u shpreh Shala. Ai përfundoi duke paralajmëruar veprime zyrtare

nga ai qoftë në pozitë apo si opozitë në të ardhme, në lidhje me këto çështje, duke shtuar se rritja e shpenzimeve në muajt e fundit është veçanërisht shqetësuese, për shkak të statusit të qeverisë në detyrë. “Kemi një qeveri që ka rritur shpenzimet dhe ka varfëruar qytetarët. Sigurisht ne do të kërkojmë sqarime dhe në vija zyrtare jemi duke i përcjellë të gjitha këto shpenzime enorme që po bëhen, veçmas në muajt e fundit kur qeveria është pa mandat,” ka përfunduar Shala.

HAXHIU SHEH NGA AFËR PUNIMET E RENOVIMIT TË OBJEKTIT TË IML-SË NË VLERË PREJ RRETH 1 MILION EURO



PRISHTINË, 22 PRILL - Ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të martën ka parë punimet e renovimit të objektit të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML). Haxhiu në rrjetin social në “Facebook” ka shkruar se për

herë të parë që nga viti 2005 po bëhen renovimet në objektin e IML-së, në vlerë prej rreth 1 milion eurosh. “Sot nga afër përcollëm punimet e renovimit të objektit të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Për herë të parë që nga viti

2005 po bëhen renovimet në objektin e Institutit të Mjekësisë Ligjore në vlerë prej një milion euro. Shpreh mirënjohjen time për secilin që ka kontribuar në jetësimin e këtij projekti madhor dhe aq të rëndësishëm. Renovimi po

realizohet në përpunje të plotë me standardet më të larta profesionale dhe teknike, me qëllim të krijimit të kushteve moderne për punë, si dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore në fushën e mjekësisë ligjore”, ka njoftuar Haxhiu.

Akreditohet atasheu i mbrojtjes i Kosovës në Gjermani

PRISHTINË, 22 PRILL - Në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Gjermani është mbajtur ceremonia e dorëzimit-pranimit të detyrës së atasheut të mbrojtjes, me ç’rast kolonel Bekim

Zejnullahu mori zyrtarisht këtë funksion të rëndësishëm nga atasheu i deritashëm nënkolonel Besim Gashi. Gjatë qëndrimit të tij në Berlin, koloneli Zejnullahu realizoi vizita të rëndësishme

në Ministrinë e Mbrojtjes së Gjermanisë dhe Bundeswehr, duke vazhduar kështu thellimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy vendeve në fushën ushtarake dhe

strategjike. Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar mbetet e përkushtuar për avancimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe përfaqësimin dinjitoz të interesave të Kosovës në nivel global.



Pas rrjedhjes së një kaldaje, kthehet në operim njësia A-4 në KEK

PRISHTINË, 22 PRILL - Pas një pune intensive dhe të pandërprerë nga ekipet përkatëse të TC Kosova A, njësia A-4 është rikthyer sërish në operim të rregullt. Kështu u bë me dije përmes një njoftimi për medie nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Në njoftim thuhet se kjo njësi kishte dalë nga prodhimi më

14.04.2025 rreth orës 08:11 për shkak të paraqitjes së një rrjedhjeje në kaldajë. “Gjatë ndërprerjes, janë eliminuar me sukses të gjitha mangësitë teknike, përfshirë edhe ato në kullën ftohëse dhe në pjesë të tjera të pajisjeve teknologjike të domosdoshme për rritjen e sigurisë së operimit të kësaj njësie. Vlen të theksohet se,

para kësaj ndaljeje, njësia A-4 kishte operuar pandërprerë për 68 ditë rresht, duke dëshmuar stabilitet të lartë dhe efikasitet në prodhim”, thuhet në njoftim. Po sipas planifikimit, përgatitjet për startimin e njësisë kanë filluar mbrëmë më 21.04.2025 rreth orës 18:55, ndërsa sinkronizimi me rrjetin

është realizuar në orë 23:30. “Aktualisht, njësia ndodhet në gjendje stabile dhe funksionon në parametra të rregullt operimi. KEK, përmes angazhimit dhe përkushtimit të vazhdueshëm, po dëshmon se mbetet një faktor kyç i stabilitetit të sektorit energjetik në vend”, ka njoftuar KEK-u.



GËRXXHALIU: SIGURIA NË PUNË DHE MBROJTJA NGA ZJARRI NË KOSOVË DUHET TË NA SHQETËSOJNË TË GJITHËVE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 PRILL - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se siguria në punë dhe mbrojtja nga zjarri në Kosovë është në një gjendje që duhet të na shqetësojë të gjithëve. “A mund të ndodhë një tragjedi si ajo në Maqedoninë e Veriut, ku humbën jetën mbi 60 persona nga një zjarr në një Klub nate në qytetin Koçan edhe në Kosovë? Po. Madje në shumë vende në Kosovë, rreziku është edhe më i lartë. Siguria në punë dhe mbrojtja nga zjarri në Kosovë është në një gjendje që duhet të na shqetësojë të gjithëve. Përtej fjalëve, realiteti në terren është i rrezikshëm dhe shpesh i anashkaluar - jo vetëm nga institucionet, por edhe nga vetë bizneset dhe qytetarët”, ka thënë ai. Gërxhaliu ka thënë se Inspektorati i Punës dhe i Emergjencave ka një numër të kufizuar të inspektorëve që

nuk përballojnë dot gjithë nevojat dhe përgjegjësitë që kanë. “Kontrollimet janë të rralla, në shumë raste vetëm formale dhe shpesh të fokusuara tek dokumentacioni, por jo te gjendja reale e sigurisë fizike në objekte”, është shprehur ai. Njohësi i ekonomisë ka thënë se mungesa e vetëdijes është alarmante. “Bizneset - nga ato të gastronomisë e deri te qendrat tregtare dhe prodhuesit - rrallëherë investojnë në pajisje të nevojshme për mbrojtje nga zjarri, si detektorë tymi, alarm zjarri, rrugë të pastra për evakuim apo trajnime për punëtorët. Në shumë lokale nate, klubet, restorantet e frekuentuara nga qindra persona çdo natë, nuk ekziston as minimumi i sigurisë. Po ashtu, edhe në institucione publike mungojnë planet për evakuim, shenjat orientuese dhe trajnimet për stafin në rast zjarri apo rreziku tjetër. Kjo situatë është rezultat i një



kombinimi të mungesës së vetëdijes, mungesës së kontrollit dhe mungesës së sanksioneve serioze. Rreziku është real dhe i pranishëm çdo ditë”, ka deklaruar Gërxhaliu, duke shtuar se në vend që të veprojmë pasi të ndodhë tragjedia, është koha që të

ndërgjegjësohemi, të investojmë në siguri dhe të kërkojmë përgjegjësi - si qytetarë, si institucione dhe si sektor privat. “Tragjedia në Koçan të Maqedonisë së Veriut duhet të jetë leksion dhe arsye që organet relevante të shtetit të veprojnë sa më parë sepse

shumë më mirë është që rreziqet eventuale të evitohen se sa të tentohet të sanohen pasi të ndodhin! Sepse siguria dhe investimet në siguri nuk janë luks, janë obligim moral dhe ligjor ndaj jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka thënë Gërxhaliu.

ÇMIMET E VEZËVE VAZHDOJNË TË RRITEN NË BE



PRISHTINË, 22 PRILL - Pas ndikimit të gripit të shpendëve në industrinë e vezëve në ShBA, çmimi global i vezëve është bërë një “pikë qendrore diskutimi” për konsumatorët. Kështu, çmimi mesatar i vezëve në BE u rrit 6.7 % në mars 2025 krahasuar me mars 2024, sipas shifrave të fundit nga Eurostat, shkruajnë mediet e huaja. Republika Çeke përjetoi normën më të lartë të inflacionit vjetor për vezët me 46 %, e ndjekur nga Sllovakia

29.8 % dhe Hungaria 26.1 %. Në anën tjetër, Holanda përjetoi uljen më të madhe të çmimeve të vezëve, me një rënie prej 3,6 %, e ndjekur nga Luksemburgu me 3,2 % dhe Greqia, ku çmimet ranë me 2 %. Deri më tani në vitin 2025, çmimet e vezëve kanë vazhduar të rriten, me një rritje prej 3,4 % në janar dhe një rritje prej 4,1 % në shkurt, krahasuar me të njëjtët muaj të vitit 2024. Ndërkohë, viti 2024 pa ritme negative ndryshimi në 10 nga

12 muaj krahasuar me vitin 2023. Megjithatë, rritjet në vitin 2025 kanë qenë më të vogla se ato të vërejtura në 2022 dhe 2023, ku çdo muaj midis prillit 2022 dhe shtatorit 2023 shënuan rritje dyshifrore. Më e madhja ishte 31.2 % në shkurt 2023 krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2022. Në vitin 2024, Franca ishte prodhuesja kryesore e vezëve me 942,000 tonë, e ndjekur nga Gjermania Spanja dhe Italia.

Anketuesit e MICS 2025 dalin në terren për listimin e ekonomive familjare

PRISHTINË, 22 PRILL - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me UNICEF-in kanë filluar punën në terren për listimin e ekonomive familjare në 450 zona të regjistrimit me qëllim të

realizimit të anketës së treguesve të shumëfishtë (MICS) 2025. Me procesin e listimit, ASK-ja dhe UNICEF-i po dëshmojnë seriozitetin dhe përgatitjen e mirë të raundit të tretë të kësaj ankete.

Realizimi i Anketës MICS 2025 është një hap shumë i rëndësishëm për zhvillimin e politikave të bazuara në të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse, sidomos kur bëhet fjalë për mirëqenien e

fëmijëve në Kosovë. Prandaj, sipas ATK-së, është me rëndësi që qytetarët t'i mirëpresin anketuesit dhe të bashkëpunojnë për ta bërë këtë proces sa më të suksesshëm.



VDEKJA ËSHTË NJË FILLIM I RI

Publikojmë parathënien e shkruar nga Papa Françesku për librin e ri të kardinalit Angelo Scola "Në pritje të një fillimi të ri. Reflektime mbi pleqërinë". Françesku e ka shkruar këtë tekst më 7 shkurt në Santa Marta, vetëm pak ditë para shtrimit në spital. Libri do të dalë të enjten më 24 prill




I kam lexuar me emocion këto faqe që burojnë nga mendimi dhe dashuria e Angelo Scola-s, vëllai im i dashur në episkopat dhe një njeri që ka mbajtur detyra delikate në Kishë, si për shembull rektor i Universitetit Papnor Lateran, më pas patriark i Venecias dhe kryepeshkop i Milanos. Para së gjithash, dua ta falënderoj thellësisht për këtë reflektim që ndërthur përvojën personale dhe ndjeshmërinë kulturore në një mënyrë që rrallë më ka ndodhur të lexoj. Njëra, përvoja, ndriçon tjetrën, kulturën; e dyta i jep përmbajtje të parës. Në këtë ndërthurje të bekuar, jeta dhe kultura lulëzojnë në bukur. Mos u mashtroni nga forma e shkurtër e këtij libri: janë faqe shumë të dendura, që duhen lexuar e rilexuar. Nga reflektimet e Angelo Scola-s nxjerr disa pika që më përputhen në mënyrë të veçantë me atë që përvoja ime më ka mësuar. Angelo Scola na flet për pleqërinë, për pleqërinë e tij, e cila – shkruan me një ton të çiltër dhe çarmatosës – “më ka

ardhur papritur dhe me një shpejtësi të befasishme, në shumë aspekte”. Që në zgjedhjen e fjalës me të cilën e përshkruan veten, “i moshuar”, ndjej një përputhje me autorin. Po, nuk duhet të kemi frikë nga pleqëria, nuk duhet të frikësohemi ta përqafojmë të qenit të moshuar, sepse jeta është jetë, dhe zbulimi i realitetit do të thotë të tradhtosh të vërtetën e gjërave. T’i rikthejmë dinjitetin një termi që shumë shpesh konsiderohet i papranueshëm është një gjest për të cilin duhet të jemi mirënjohës ndaj kardinalit Scola. Sepse të thuash “i vjetër” nuk do të thotë “për t’u hedhur”, siç ndonjëherë një kulturë e degraduar e hedhjes na çon të mendojmë. Të thuash “i vjetër” do të thotë të thuash përvojë, mençuri, urtësi, dallim, maturi, dëgjim, ngadalësi... Vlera që na duhen më shumë se kurrë! Është e vërtetë, bëhesh i moshuar, por problemi nuk është ky: problemi është si bëhesh i moshuar. Nëse e

jetojmë këtë kohë të jetës si një hir, dhe jo me hidhërim; nëse e pranojmë këtë kohë (qoftë edhe të gjatë) në të cilën përjetojmë rënie të forcave, lodhjen fizike që shtohet, reflekset që nuk janë më si në rini, me ndjenjë mirënjohjeje dhe njohjeje, atëherë edhe pleqëria bëhet një moshë e jetës, siç na ka mësuar Romano Guardini, vërtetë pjellore dhe që mund të rrezatojë të mira. Angelo Scola vë në dukje vlerën, njerëzore dhe shoqërore, të gjyshërve. Kam theksuar disa herë se roli i gjyshërve është me rëndësi themelore për zhvillimin e ekuilibruar të të rinjve, dhe në fund të fundit për një shoqëri më paqësore. Sepse shembulli i tyre, fjala e tyre, urtësia e tyre mund të mbjellin te më të rinjtë një vështrim të gjatë, kujtesën e së shkuarës dhe një ankorim tek vlerat që mbeten. Brenda vrullit të shoqërive tona, shpesh të dhëna pas të përkohshmes dhe pas dëshirës së sëmure për dukje, urtësia e gjyshërve bëhet një fener që ndriçon, ndriçon pasiguritë dhe u jep drejtim nipërve dhe

mbesave, të cilët mund të nxjerrin nga përvoja e tyre një “diçka më shumë” për jetën e tyre të përditshme. Fjalët që Angelo Scola i kushton temës së vuajtjes, që shpesh shfaqet në procesin e plakjes, dhe rrjedhimisht edhe vdekjes, janë margaritarë të çmuar besimi dhe shprese. Në mënyrën e të shprehurit të këtij vëllai peshkop ndjej të jehojë teologjia e Hans Urs von Balthasar-it dhe e Joseph Ratzinger-it, një teologji “e bërë në gjuhë”, e përshkuar nga lutja dhe dialogu me Zotin. Për këtë arsye thashë pak më parë se këto janë faqe që burojnë “nga mendimi dhe nga dashuria” e kardinalit Scola: jo vetëm nga mendimi, por edhe nga dimensionin emocional, i cili është ai që feja e krishterë na kujton, sepse krishterimi nuk është aq një veprim intelektual apo një zgjedhje morale, sesa një dashuri ndaj një personi, atij Krishti që na ka dalë përpara dhe ka vendosur të na quajë miq. Pikërisht përfundimi i këtyre faqeve të Angelo Scola-s, që janë një rrëfim me zemër të

hapur për mënyrën se si po përgatitet për takimin përfundimtar me Jezusin, na kthen një siguri ngushëlluese: vdekja nuk është fundi i gjithçkaje, por fillimi i diçkaje. Është një fillim i ri, siç thekson me mençuri titulli, sepse jeta e përjetshme, të cilën ai që dashuron e përjeton që këtu në tokë, mes punëve të përditshme, është një fillim i diçkaje që nuk do të përfundojë kurrë. Dhe pikërisht për këtë arsye është një fillim “i ri”, sepse do të jetojmë diçka që kurrë nuk e kemi jetuar plotësisht: përjetësinë. Me këto faqe në dorë, do të doja të bëja, në mënyrë simbolike, të njëjtin gjest që bëra sapo veshja petkun e bardhë të Papës, në Kapelën Sistine: të përqafoj me respekt të madh dhe dashuri vëllain Angelo, tani të dy më të vjetër se atë ditë të marsit 2013. Por gjithmonë të bashkuar nga mirënjohja ndaj këtij Zoti të dashur që na ofron jetë dhe shpresë në çdo moshë të jetës sonë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

United Basketball në Superligë

PRISHTINË, 22 PRILL - United Basketball, pasi triumfoi ndaj Vëllaznimit në dy finale të zhvilluara, u shpall kampione e Ligës së Parë Femrat dhe tashmë është zyrtarisht

në Superligën Femrat për edicionin e ardhshëm. Me dy fitore të fuqishme kundër rivalit të fortë, Vëllaznimit, Unitedi arriti të shpallet kampione. Finalet ishin përplot

adrenalinë, emocione dhe spektakël. Medaljet dhe trofeu i Kupës u dhanë nga anëtarët e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Ideal Bakija, i cili ishte i pranishëm. Tia

Tuhina nga Unitedi u shpall MVP pas një paraqitjeje të shkëlqyeshme në parket. Çmimin për më të mirën e ndeshjes e dha, po ashtu, Ideal Bakija.



Kosova shënon fitoren e dytë radhazi në turneun zhvillimor të UEFA-s

PRISHTINË, 22 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës U16 ka vazhduar paraqitjet mbresëlënëse në kuadër të turneut zhvillimor të UEFA-s, duke shënuar edhe fitoren e dytë radhazi. Të përzgjedhurit e trajnerit Mehmed Kurda mposhtën Andorrën me rezultat 2:1, në një ndeshje ku dominuan me lojë dhe karakter. Hero i kësaj sfide ishte Unejs Mustafa i cili realizoi të dyja golat për "dardanët" e rinj. Ai e kaloi Kosovën në epërsi në minutën e 40, ndërsa e dyfishoi epërsinë në fillim të pjesës së dytë (48'), kur shënoi edhe golin e dytë personal dhe të ekipit, duke i siguruar Kosovës epërsinë e nevojshme për fitore. Pas ndeshjes, Mustafa u shpreh i lumtur për golat dhe fitoren: "Jam shumë i lumtur që i kam dhënë dy gola. Është fitorja e dytë me Kombëtaren e Kosovës dhe shpresoj të ecim

kështu. Besoj se edhe në ndeshjen e tretë kundër Shqipërisë do të arrijmë sukses". Në minutat e fundit të ndeshjes Andorra arriti të shënojë një gol për ta ngushtuar rezultatin në 2:1, por pa arritur ta rrezikojë seriozisht fitoren e Kosovës. Trajneri Mehmed Kurda u shpreh i kënaqur me angazhimin dhe karakterin e treguar nga lojtarët: "Edhe sot djemtë treguan karakter të fortë, edhe pse patëm një kundërshtar jashtëzakonisht të fortë dhe të papërshtatshëm, ia arritëm të fitojmë 2:1. I përgëzoj djemtë për përkushtimin dhe paraqitjen dinjitoze në këtë turne". Ndeshjen e fundit në këtë turne zhvillimor Kosova U16 do ta luajë më 25 prill kundër Shqipërisë, ku synon ta mbyllë me sukses të plotë këtë paraqitje të shkëlqyer.



Gashijani, 'Ylli i javës' në Superligë



PRISHTINË, 22 PRILL - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 30 në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të KF Llapi, Elvir Gashijani. Vlerësimi për më të mirin e javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Muhamet Sylejmanit, Agim Maliqit dhe Fisnik Ademit. Ky

komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e tridhjetë t'i takojë Elvir Gashijanit, i cili shënoi një gol dhe asistoi për një tjetër, duke u bërë lojtarë më i dobishëm i skuadrës së tij në fitoren e rëndësishme në udhëtim kundër Malishevës, e cila përfundoi me rezultat 1:3: "Ishte ndeshje e vështirë, por jemi përgatitur shumë mirë. Forma e lojtarëve ishte maksimale.

Grupi dhe atmosfera në ekip janë shumë të mira dhe besoj se do të triumfojmë edhe në ndeshjen e Kupës së Kosovës. Jam shumë i lumtur që jam shpallur më i miri i javës dhe dua t'i falënderoj bashkëlojtarët për përkrahjen, familjen, klubin dhe dy njerëzit që janë gjithmonë afër meje - Afrim Ajetin dhe Adil Vokrrin", ka thënë Gashijani për faqen zyrtare të FFK-së.

Jep dorëheqje drejtori sportiv i Gjilanit, Ertan Demiri

GJILAN, 22 PRILL - Drejtori sportiv i SC Gjilani, Ertan Demiri, ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij në klub, të cilin veprim e ka quajtur moral për shkak të rezultateve të dobëta të klubit në javët e fundit. Demiri erdhi si pjesë e ristrukturimit të klubit, kur u konsolidua kryesia e re, së bashku me trajnerin Ardian Nuhui. "Të nderuar miq dhe dashamirë të futbollit, në

veçanti e nderuara kryesi e klubit SC Gjilani, tifozë, përkrahës dhe mbështetës të klubit. Pas një viti angazhim në postin e drejtorit sportiv - kur përjetuam shumë momente gëzimi, por edhe sfida në ndërtimin dhe hapërimin e klubit drejt përmbushjes së synimeve tona - për shkak të rezultateve të fundit kam vendosur të jap dorëheqje. Këtë

ia kam kuptuar edhe kryetarit të klubit, Fatlum Pirevës në takimin e mbrëmshëm", ka thënë Demiri. "Mbi të gjitha e falënderoj Zotin e pastaj presidencën e klubit për mbështetjen dhe bashkëpunimin në drejtimin e këtij klubi të madh me tifozeri të jashtëzakonshme. Ndaj bindjen se me këtë kryetar dhe me këtë tifozëri, SC Gjilani ka para vetes një të ardhme të artë! Njashtu

besoj se puna ime do të japë frytet në të ardhmen dhe do të ngelë një shtyllë shtesë drejt suksesit të klubit", thuhet në këtë njoftim. Në pesë ndeshjet e fundit Gjilani ka realizuar vetëm një fitore, një barazim dhe tri humbje, duke rënë në pozitën e shtatë në tabelë, me 39 pikë, vetëm dy pikë larg zonës së barazhit dhe gjashtë nga rënia prej lige.



Clippersat dhe Pistonsi barazojnë serinë në ‘play-off’

DENVER, 22 PRILL - Kanë vazhduar ndeshjet spektakolare në “play-off” të NBA-s, ku Los Angeles Clippersi ka barazuar serinë në 1-1 ndaj Denver Nuggetsit. Pas një ndeshje fantastike, clippersat triumfuan me rezultat të

ngushtë 105:102 në fushën e Nuggetsit. Qendra Nikola Jokiq ishte më efikasi te skuadra vendase me 26 pikë, 12 kërcime dhe 10 asistime, por nuk u mjaftoi nuggetsave, pasi shkëlqeu Kawhi Leonard me 39 pikë për skuadrën fituese. Të

Nuggetsi me lojë të mirë u dallua edhe Jamal Murray me 23 pikë, por as kaq nuk i mjaftoi Denverit. Tashmë seria kalon në Los Angeles dhe Clippersi arriti ta “vjedhë” avantazhin e fushës vendase në seri duke e barazuar në 1:1. Në ndeshjen

e dytë të mbrëmjes, Detroit Pistons mposhti New York Knicksin jashtë shtëpisë me rezultatin 100:94 dhe kështu barazoi serinë në 1:1. Mysafirët u prinë drejt fitores nga Cade Cunningham me 33 pikë dhe 12 kërcime, ndërsa Dennis Schroeder shënoi 20



pikë. Në skuadrën e mundur, Jalen Brunson shënoi plot 37.

Tare edhe me afër Milanit

MILANO, 22 PRILL - AC Milan është ende në kërkim të drejtorit të ri sportiv dhe, ndonëse emri përfundimtar nuk është bërë ende publik, Igli Tare duket se është në pole position. Sipas asaj që raporton “La Gazzetta dello Sport”, zhvillimet e fundit konfirmojnë se pas takimit të gjatë disa ditë më parë në Romë mes Tares dhe CEO-së së Milanit, Giorgio Furlani, ka pasur kontakte të reja mes palëve dhe një takim i dytë pritet të mbahet së shpejti. Edhe pse data e këtij takimi të ri nuk është përcaktuar ende, pritshmëritë janë që të ndodhë brenda pak ditësh. Klubi kuqezi dëshiron ta marrë kohën e duhur për të analizuar çdo mundësi, por koha po bëhet një faktor presioni: vera është afër dhe Milani synon që vendimi përfundimtar të merret brenda gjysmës së parë të muajit maj. Gjatë takimit të ardhshëm, Furlani dhe Tare



pritet t’i vazhdojnë diskutimet pozitive të nisura në Romë. Ky takim mund të shërbejë si pikë kthese: ose pista Tare do të braktiset, ose do të finalizohet marrëveshja me një takim të fundit, për ta filluar menjëherë punën dhe ndërtimin e Milanit të sezonit të ri. Ndërkohë, nëse Tare merr drejtimin e merkatos kuqezi, ka nisur të përflitet edhe për emra të rinj. Sipas të

njëjtave burime, për repartin ofensiv objektivi i parë mund të vijë nga Bundesliga: bëhet fjalë për Jonathan Burkardt, sulmuesi 24-vjeçar i Mainzit, i cili këtë sezon ka realizuar 16 gola dhe ka dhënë tri asistime në kampionat dhe në Kupën e Gjermanisë. Me paraqitjet e tij të mira, Burkardt ka arritur ta veshë edhe fanellën e kombëtares gjermane.

Verstappeni ‘përçan’ pilotët e McLarenit, zgjedh favoritin për titullin kampion në F1

SURREY, 22 PRILL - Piloti australian Oscar Piastri është lideri i ri i Botërorit të Formulës 1 këtë sezon. Pas zhgënjimit në garën e parë sezonale, atë në pistën e shtëpisë, ai ka arritur tri fitore në katër garat efundit, duke marrë edhe kreun e renditjes. Madje Piastri ka dominuar së fundi në përballjen e drejtpërdrejtë me Lando Norris. Ai tani ka 10 pikë epërsi ndaj shokut të tij të skuadrës dhe 12 pikë diferencë ndaj Max Verstappenit me Red Bullin. Në garën e fundit në Arabi, Piastri ishte i akullt dhe i ftohtë në përballjen me Verstappenin në kthesën e parë. Më pas ai tregoi pjekuri në menaxhimin e garës, duke demonstruar se nuk i mungon aspak guximi. Max Verstappen e vlerëson si rival të fortë, duke deklaruar se Piastri ka gjithçka për ta synuar titullin për pilotë: “Ai është në



vitin e tretë në F1, është shumë solid dhe konsistent. Ka një qasje shumë të qetë dhe është një karakteristikë që më pëlqen. Këtë gjë e tregon në pistë dhe bën shumë pak gabime. Këto janë cilësitë që duhen kur dëshiron të luftosh për një kampionat. Unë, gjithashtu, mendoj se edhe Mark Weberi përkrah tij po e

ndihmon shumë atë”, ka deklaruar Verstappen. “Njerëzit mësojnë nga karriera e tyre dhe Webber me Piastri po bën atë që babai im bëri me mua përmes këshillave të vlefshme. Oscar i thjesht po e përdor talentin e tij dhe kjo është një gjë e mrekullueshme”, ka përfunduar Verstappen.

SHKURT

Galatasaray me ofertë tunduese për Xhakën

Granit Xhaka mund të largohet nga Bayer Leverkuseni në fund të këtij sezoni, pavarësisht kontratës që e lidh me klubin gjerman deri në vitin 2028. Sipas “Sky Deutschland”, drejtuesit e Leverkusenit janë të hapur për ta lënë mesfushorin zviceran të largohet nëse paraqitet një ofertë e kënaqshme, edhe pse për një shumë modeste. Mesfushori me origjinë shqiptare, që ishte një nga lojtarët më të rëndësishëm në skemat e Xabi Alonsos këtë sezon, mund të nisë një aventurë të re. Galatasaray ka nisur tashmë kontaktet dhe po punon për t’i ofruar një kontratë të majme, me synimin për ta bindur Xhakën të transferohet në Stamboll. Por nuk është vetëm klubi turk në garë. Edhe ekipe nga Arabia Saudite kanë shfaqur interes të fortë për 32-vjeçarin, duke i shtuar më shumë dilema të ardhmes së tij. Xhaka, i cili iu bashkua Leverkusenit nga Arsenalit në verën e vitit 2023 për 15 milionë euro, mund të jetë drejt fundit të aventurës në Bundesliga.

Kumbulla në formacionin e javës në Spanjë

Marash Kumbulla po kalon një çast të artë në elitën e futbollit spanjoll. Mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare është shpërblyer për paraqitjet e tij të shkëlqyera me përfshirjen në formacionin e javës në La Liga, duke dëshmuar edhe një herë vlerat dhe profesionalizmin e tij. Ai shënoi golin e vetëm të Espanyolit në fitoren ndaj Getafes, shumë e rëndësishme për sigurimin sa më parë të mbijetesës. Pas një periudhe të vështirë me lëndime dhe mungesë vazhdimësie te Roma, Kumbulla ka rigjetur veten në Spanjë, ku është bërë një shtyllë në prapavijën e skuadrës së tij. Në ndeshjen e fundit, ai spikati me ndërhyrje vendimtare, qetësi në ndërtimin e lojës dhe dominim në duelet ajrore karakteristika që i kanë dhënë atij vlerësime të larta nga mediet dhe analistët sportivë. Përfshirja në “11-shen ideale” të javës në një kampionat kaq konkurrues si La Liga është një arritje e rëndësishme për qendërmbrojtësin kuqezi.

Leverkuseni nuk vendos pengesa për Alonson

Fernando Carro, CEO i Bayer Leverkusenit, foli për lamtumirën e mundshme të trajnerit Xabi Alonso, i cili mund ta marrë drejtimin e Real Madridit. “Ka një marrëveshje zotërinjsh – janë fjalët e drejtorit gjerman. Nëse një klub për të cilin ai ka luajtur vjen për të negociuar, ne do të ulemi dhe do të flasim pa vënë pengesa. Ne tashmë po planifikojmë përgatitjen dhe skuadrën me Xabi Alonson. Nëse ai do të largohej në fund, ne duhet ta sqarojmë me të në javët e ardhshme. Nuk mund të presim deri në fund të sezonit”. Ndërkohë, për yllin e skuadrës, Florian Wirtz, Carro ka shtuar: “Unë pres që ai të qëndrojë. Nuk ka asnjë ofertë nga Bayerni. Ata flasin shumë, por nuk është korrekte, duket thjesht si një shfaqje”.

Klubet saudite kërkojnë katër futbollistë të Barcelonës

Klubet e Superligës së Arabisë Saudite e kanë kthyer fokusin te Barcelona. Përfaqësuesit nga Al Hilal, Al Nassr dhe Al Ittihad kanë udhëtuar në Spanjë për të folur me klubin rreth marrëveshjeve të mundshme

me vlerë të lartë. Sipas gazetës “Sport”, Al Hilal dëshiron Raphinha dhe është gati të ofrojë një marrëveshje që do ta trefishonte pagën e tij aktuale. Bisedimet për një kontratë të re me Barcelonën kanë ngecur,

kryesisht për shkak të kohëzgjatjes së marrëveshjes dhe kërkesave për paga. Al Nassri thuhet se është i interesuar për mbrojtësit Jules Kounde dhe Ronald Araujo. Sipas raportit, Barcelona nuk ka plane ta shesë

asnjërin nga lojtarët nëse nuk vjen një ofertë e madhe. Andreas Christensen është përmendur gjithashtu si një objektivi i mundshëm. Al Ittihad ka pyetur për mesfushorin Frenkie de Jong. Raporti shton se edhe pse

pozicioni i tij ishte i paqartë vitin e kaluar, ai tani pritet të nënshkruajë një kontratë të re dhe të qëndrojë në klub. Megjithatë, një ofertë mjaft e madhe mund ta testojë vendosmërinë e Barcelonës.



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u kompaniji RPO "PASTRIMI" a.d. konkretno članovi 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" A.D., u Odluci od 18.04.2025. godine sa brojem protokola 02/01/337 izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" A.D, objavite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv posla:	Administrativni supervizor
Ne. Obavezno:	Jedna (1) pozicija u RPO "PASTRIMI" A.D.
Referentni broj:	DA/KJ/13/2025
Koeficijenti / Mesečne plate:	Nivo XII
Trajanje ugovora o radu:	Sa neodređenim vremenom
Probni rok:	3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Učestvuje u radnim odborima koje dodeljuje direktor administracije
- Pomaže i pomaže direktoru operacija za nesmetano odvijanje radova u jedinicama koje su u sastavu Direkcije za administraciju
- Sprovodi preporuke direktora uprave u vezi sa kontinuitetom rada ostalih zaposlenih.
- Izrađuje dnevne, nedeljne, mesečne i godišnje planove za svoj rad,
- obavlja poslove i druge poslove u vezi sa opisom radnih zadataka koje zahtevaju rukovodioci Odeljenja za pomoćne poslove;
- Za svoj rad odgovoran je šefu Jedinice za podršku i direktoru administracije

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ biti državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ Potrebno obrazovanje: Visoka stručna sprema ili školarina u srednjoj školi
- ✓ Potrebno radno iskustvo: 1 godina profesionalnog radnog iskustva

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE starije od 6 meseci	✓

6. Kako se prijaviti na konkurs i prijaviti se:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
- * preuzimanjem sa zvaničnog sajta na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "PASTRIMI" AD.
 - * u Kancelarijama za ljudske resurse RPO " PASTRIMI " a.d.

6.2 Podnošenje prijave vrši:

- * samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com i
- * čak iu fizičkom obliku u slučajevima tehničkih pozicija.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;

Javni konkurs traje 15 dana od 23.04.2025. do 08.05.2025. godine.

Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Kandidati se ocenjuju na osnovu biografije, pismenog testa i intervju (usmeni test).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- ✓ Pismeni test se ocenjuje do šezdeset (60) bodova;
- ✓ Intervju (usmeni test) se ocenjuje do trideset (30) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obavешtavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavешteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervju do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervju.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erëblina Zymberi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Marie Prenkaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Dijon Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Valentin Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhde e Hasit.
- Jeton Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhde e Hasit.
- Sadije Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- Venera Qollaku shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Luciano Motroni" Prizren.
- Alnor Boshnjaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Saime Muhaxhiri B.I. nga Gjakova të numrit fiskal 810246331 të lëshuar nga ARBK.
- Shpresa Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Damjan Gjakovë. Nga kl 1-8
- Fatlinda Fazlija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Resmije Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Nikë Deda shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 400 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L